



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
DREJTORIA E QENDRES SPITALORE RAJONALE BERAT
NJESIA E PROKURIMIT

Nr. _____ Prot.

Berat, më / /2025.

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Mallra
PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR
KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Furnizim me Oxygen - Gaz për përdorim mjekësor i kompresuar x 100%” për një periudhë 15 (pesëmbëdhjetë) muajore” - *Marrëveshje Kuadër me një operator të vetëm ekonomik fitues ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, për një periudhë 15 muaj nga nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër.*

Fondi limit* vlera e pritshme e kontratave ne marrëveshjen kuadër: 15,939,000 (Pesëmbëdhjetë milion e nëntëqind e tridhjetë e nënte mijë) lekë pa TVSH.

Fondi limit është perlogaritur bazuar ne V.K.M. nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar neni 76 në titullin “Mënyrat për përlogaritjen e vlerës së prokurimit” pika 1. Në përlogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti/enti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura, si më poshtë vijon: germa c) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe referuar ne rastin konkret Autoriteti Kontraktor ne përlogaritjen e fondit limit është bazuar çmimet e kontratave të mëparshme të realizuara nga vete AK të tregut pasqyruar ne process verbal.

Përlogaritja e fondit limit është dokumentuar nga komisioni i argumentimit të përlogaritjes së fondit limit të procedurës me shkresën Nr. 4042 Prot., datë 24.07.2025.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe në përputhje me shkresën E MSHMS Nr. 486 Prot datë 28.01.2025 me objekt: Udhëzim mbi kryerjen e disa procedurave të prokurimit publik protokollur këtu me Nr.611 prot., dt 30.01.2025, kërkesës së miratuar me Nr. 4013 prot., datë 23.07.2025. Procesverbalit nga Specialisti I fushen në lidhje me specifikimet teknike dhe kriteret e fushës I datës 06.08.2025.

Burimi i Financimit : Me të ardhurat e Buxhetit të Shtetit.

Forma juridike e finalizimit të procesit të prokurimit do të jetë; **Marrëveshje Kuadër me 1 Operator Ekonomik, kur të gjitha kushtet janë të përcaktuara.** Duke qënë se objekti i prokurimit është një mall që përdoret në mënyrë të përsëritur, i rëndësishëm, i cili do të zgjasë për një kohë të gjatë, dhe ka ndikim direkt në mbarëvajtjen e punës së AK. Të gjitha kushtet e kontratës do të jenë të përcaktuara ashtu si dhe çmimet e

ofertës fituese dhe shërbimi do të kryhet bazuar në këto kushte e cmime. Sasitë do të jenë variabël nga kërkesat e AK së, duke mos tejkaluar vlerën dhe afatin e marrëveshjes kuadër.

Bazuar në nenin 39 të LPP-së i ndryshuar dhe në nenin 42 të V.K.M. nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Autoriteti Kontraktor vendos te mos e ndajë procedurën e prokurimit ne lote per arsye sepse kjo garanton dhe siguron efektivitet në lidhje me shpejtësinë e kryerjes se shërbimeve. Autoriteti/enti Kontraktor **Qendra Spitalore Rajonale Berat** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Shtojca 8.

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

OFERTUESI DEKLARON SE:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, **sipas Shtojcës 9.**

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimi nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/Enti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

Argumentimi: Kërkesat e përgjithshme të kualifikimit dhe kërkesat e pikës 1 (gërmat a / b) të kritereve të veçanta të kualifikimit janë parashikuar pa ndryshime, sipas formatit të dokumenteve standarde të tenderit të publikuara nga APP, dhe vendosja e tyre është bazuar në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4; 318,780 (treqind e tetëmbëdhjetë mijë e shtatë qind e tetëdhjetë*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

2.1.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Licencë të vlefshme të lëshuar nga QKL ose QKBPM për tregtim me shumicë të barnave.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 5, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për prodhimin dhe/ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2022, 2023, 2024), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së fondit limit të përlogaritur.

Nëse operatorët ekonomikë, arrijnë vlerën e xhiros minimale të kërkuar në këto DT, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar, kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur.

Argumentimi:Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” I ndryshuar, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” I ndryshuar. Autoriteti Kontraktor ka konsideruar të nevojshme përfshirjen e kriterit të cituar më lart, në mënyrë që t’i shërbejë autoritetit/entit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës të mundshëm si dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës. Kërkesa e mësipërme është në përpjesëtim dhe e lidhur ngushtë me objektin e kontratës. Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:
Në zbatim, neni 77 pika 3”Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40 % të vlerës së përlogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave”. Bazuar në nenin 43 pika 2/b dhe pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” I ndryshuar ku përcaktohet: Neni 43 pika 2/b *Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: b) vlerën e parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore* është bërë bazuar në nenin 43 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ku përcaktohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare;* si dhe nenit 13 të Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 “Për Tatimin Mbi të Ardhurat” i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për deklaratat individuale vjetore të ardhurave

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Bazuar në nenin 43 pika 3 dhe 43 pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku përcaktohet: Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: b) vlerën e përlogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;

Neni 43 pika 3

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Neni 43 pika 5

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale, llogaritet mbi bazën e vlerës maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohej, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 13 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 'Për Tatimin Mbi të Ardhurat' i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për Deklaratat individuale vjetore e të ardhurave; si dhe në nenin 29, të Ligjit Nr. 8438, dt. 28.12.1998 "Për Tatimin mbi të Ardhurat", i ndryshuar, ku përcaktohet: Çdo tatimpagues pergatit deklaraten vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaraten vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, vlerësojmë se vërtetimin për xhiron vjetore të certifikuar të vitit 2023, operatorët ekonomikë mund ta disponojnë pas paraqitjes së deklaratës vjetore në organet tatimore, për të cilën kanë patur afat deri më 31.03.2024. Gjithashtu me qëllim mos penalizimit të asnjë operatori ekonomik ky kriter është lene me alternative pra një operator ekonomik mund të paraqesë vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022, 2023 ose 2022, 2023, 2024 pasi afati për dorëzimin e deklaratave vjetore të vitit 2024 sipas dispozitave të sipercituara është deri në datë 31.03.2025 (Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore)

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më e vogël se 20 % e vlerës së fondit të limitit të kësaj procedure prokurimi.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara

ose

për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara

Argumentimi :Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenin 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e

nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit të kontrates (*apo shumatores së fondit limit të loteve, nëse kontrata është e ndarë në lote dhe ofertohet për më shumë se një lot*), që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme kerkohet për të vërtetuar aftësitë teknike të OE me qëllim përmbushjen nevojave të AK. duke shërbyer kështu si një garanci për AK, që ofertuesit zotërojnë kapacitete dhe eksperiencë për të zbatuar marrëveshjen kuadër, me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie dhe në përmbushje të specifikimeve teknike

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të vetëdeklarojë origjinën e mallit, kompaninë prodhuese/MAH (të plotësohet në shtojcën 3 “**LISTA E ÇMIMEVE TË ARTIKUJVE**” të DST)

Argumentimi: Kjo kerkese vendoset me qëllim njohjen e origjinës së mallit dhe kompaninë prodhuese për të identifikuar në mënyrë të qartë atë gjatë lëvrimin të tij dhe për të pasur sigurinë që i njëjti mall i ofertuar do të lëvrohet në destinacion. Ky kriter është në përputhje me nenin 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, dhe kjo kerkese i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE për përmbushjen me sukses të kontrates pra të garancisë së furnizimit të mallit objekt prokurimi.

2.3.3 Kerkohet të paraqitet: Dokumenti i cili konfirmon se bari i ofertuar, është i pajisur me autorizim për tregtim në Republikën e Shqipërisë, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore /ose/ Autorizimi për tregtim i barit, lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, brenda afatit të tij të vlefshmërisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40, pika 8 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë Autorizim prodhuesi për tregtim të materialeve objekt prokurimi, që i mundëson Autoritetit Kontraktor për të verifikuar dhe krijuar besimin që OE ofertues është në gjendje të realizojë punën/ shërbimin në mënyrë cilësore që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente dhe që vlerësohet e nevojshme për realizimin me sukses të kontratës

2.3.4 Kërkohet Autorizim (i vlefshëm për periudhën 2025 - 2026), lëshuar nga MAH (mbajtësi i autorizimit të tregtimit), nëpërmjet të cilit konfirmohet se ofertuesi autorizohet të tregtojë barnat e tij në vendin tonë.

Shënim: KVO rezervon të drejtën e verifikimit të të dhënave të paraqitura nga ofertuesit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 40, pika 8 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë Autorizim prodhuesi për tregëtim të materialeve objekt prokurimi, që i mundëson Autoritetit Kontraktor për të verifikuar dhe krijuar besimin që OE ofertues është në gjendje të realizojë punën/ shërbimin në mënyrë cilësore që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente dhe që vlerësohet e nevojshme për realizimin me sukses të kontratës.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të provojë se, nëse shpallet fitues, do të ketë në dispozicion minimumi **150-200** bombola oksigjeni mjekësor / pako bombola, në pronësi ose me qira. Për të vertetuar këtë kriter, operatori ekonomik duhet të deklarojë se ka në pronësi këtë sasi bombolash. Për të vertetuar këtë kriter, operatori ekonomik duhet të paraqesë një dëshmi për pasjen në pronësi të kësaj sasive bombolash (fature blerje ose dokument doganor për importimin e bombolave të oksigjenit ose çdo lloj dokumenti tjetër ligjor i cili dëshmon disponimin në pronësi të këtyre bombolave), /ose/ kontrate apo marrëveshje paraprake për marrjen me qira të kësaj sasive bombolash bashkëngjitur dokumentin e pronësive të qiradhenesit (fature blerje /ose/ dokument doganor për importimin e bombolave të oksigjenit ose çdo lloj dokumenti tjetër ligjor i cili dëshmon disponimin në pronësi të këtyre bombolave, ***Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 9 të DST.**

Argumentimi: Ky kriter vendoset në mbështetje të pikës 2 dhe 4 të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020, “Për Prokurimin Publik” dhe bëhet me qëllim krijim të bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë teknike të OE ofertues, nëpërmjet pasjes së burimeve/kapaciteteve të mjaftueshme për furnizimin me sasine dhe llojin e kërkuar nga AK dhe që ka aftësinë e duhur për zbatimin e kontratës siç është parashikuar në DST.

2.3.6 Certifikate **ISO 9001-2015** ose ekuivalent, të vlefshme, për distribucionin e gazrave mjekësore, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.- Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, kriteri i sipërpermendur plotësohet nga secili operator ekonomik .

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 4/a dhe nenit 44 pika 1 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Me

anë të këtij kriteri kërkohet që Autoriteti ose enti kontraktor të vërtetojë se shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit. Bazuar në këto dispozita Autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dorëzimin e certifikatave ose dokumenteve të ngjashme, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e tyre me standardet e kërkuara të cilësisë, veçanërisht sa i takon: a) garantimit të aksesit të personave me aftësi të kufizuara; b) efikasitetit të energjisë; c) sistemeve të menaxhimit mjedisor.

- ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërrmarjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t'i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime me të ulta.

ISO 9001:2015 përfaqëson standartin ndërkombëtar unanim i njohur si standarti që i perket kërkesave për një sistem menaxhimi të cilësisë. Ky standart aplikohet për çdo shoqëri pavarësisht madhësisë ose fushës së aktivitetit. AK gjykon se kërkesa për pajisjen e Ofertuesve me Certifikatat e kërkuara, është brenda kuadrit të parashikuar nga legjislacioni për prokurimin publik. Certifikatat e kërkuara janë në përpjestim me objektin e kontratës dhe respektojnë natyrën e mallit duke patur parasysh se furnizimi i kërkuar është tepër sensitiv dhe ka impakt në mjedis. Gjithashtu të gjitha certifikatat ISO të sipërcituara janë vendosur konform 1 të nenit 79 të Ligjit nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik" i ndryshuar nën titullin "Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor" pika 1 ku përcaktohet se "1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit." si dhe në zbatim të rekomandimit të APP dhe DPA datë 20.03.2018

2.3.7 Certifikate OHSAS 18001:2007, të vlefshme, për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë / ose / ISO 45001-2018 (certificate ekuivalente të azhuruara), **ose ekuivalent**. Certifikata të jetë lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, kriteri i sipërpermendur plotësohet nga secili operator ekonomik

- **Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 4/a dhe nenit 44 pika 1 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që Autoriteti ose enti kontraktor të vërtetojë se shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit. Bazuar në këto dispozita Autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dorëzimin e certifikatave ose dokumenteve të ngjashme, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e tyre me standardet e kërkuara të cilësisë, veçanërisht sa i takon: a) garantimit të aksesit të personave me aftësi të kufizuara; b) efikasitetit të energjisë; c) sistemeve të menaxhimit mjedisor. AK gjykon se kërkesa për pajisjen e Ofertuesve me Certifikatat e kërkuara, është brenda kuadrit të parashikuar nga legjislacioni për prokurimin publik. Certifikatat e kërkuara janë në përpjestim me objektin e kontratës dhe respektojnë natyrën e mallit duke patur parasysh se furnizimi i kërkuar është tepër sensitiv dhe ka

impakt ne mjedis. Gjithashtu te gjitha certifikatat ISO te sipercituara jane vendosur konform 1 te nenit 79 te Ligjit nr.162/2020 “Per Prokurimin Publik” i ndryshuar nen titullin “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” pika 1 ku percaktohet se “1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.” si dhe ne zbatim të rekomandimit të APP dhe DPA datë 20.03.2018

2.3.8 Certifikatë ISO 14001:2015 –Sistemi i menaxhimit mjedisor ose ekuivalent, të vlefshme, për distribucionin e gazrave mjeksore, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, kriteri i siperpermendur plotësohet nga secili operatore ekonomik .

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 4/a dhe nenit 44 pika 1 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. *Me anë të këtij kriteri kërkohet që Autoriteti ose enti kontraktor të vërtetojë se shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit. Bazuar në këto dispozita Autoriteti ose enti kontraktor mund t’u kërkojë ofertuesve dorëzimin e certifikatave ose dokumenteve të ngjashme, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e tyre me standardet e kërkuara të cilësisë, veçanërisht sa i takon: a) garantimit të aksesit të personave me aftësi të kufizuara; b) efijencës së energjisë; c) sistemeve të menaxhimit mjedisor.*

- ISO 14001:2015 ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001:2015 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i shërbimit objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky çertifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit. AK gjykon se kërkesa për pajisjen e Ofertuesve me Çertifikatat e kërkuara , është brenda kuadrit të parashikuar nga legjislacioni për prokurimin publik. Çertifikatat e kërkuara janë në përpjestim me objektin e kontratës dhe respektojnë natyrën e mallit duke patur parasysh se furnizimi i kërkuar është teper sensitiv dhe ka impakt ne mjedis. Gjithashtu te gjitha certifikatat ISO te sipercituara jane vendosur konform 1 te nenit 79 te Ligjit nr.162/2020 “Per Prokurimin Publik” i ndryshuar nen titullin “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” pika 1 ku percaktohet se “1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.” si dhe ne zbatim të rekomandimit të APP dhe DPA datë 20.03.2018

2.3.9 Operatori ekonomik duhet te vertetoje se bombolat e oksigjenit, qe do te furnizohen prej tij, plotesojne kushtet teknike te pajisjeve nen presion. Per kete duhet te paraqese vërtetim te leshuar, i vlefshem per vitin 2025,

nga organet kompetente për regjistrimin, kontrollin e kushteve teknike dhe te sigurisë, për enët nën presion tankera/serbatore/cisterna, konform legjislacionit në fuqi, ku të jenë përcaktuar numri dhe kapaciteti i tyre, data e kontrollit, organi inspektues dhe plotesimi i standarteve, kushteve teknike dhe te sigurisë

Argumentimi: Ky kriter vendoset në mbështetje të pikës 2 dhe 4 të nenit 77 të Ligjit nr. 162/2020,

“Për Prokurimin Publik” dhe bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë teknike të OE ofertues, nëpërmjet pasjes së burimeve/kapaciteteve të mjaftueshme për furnizimin me sasinë dhe llojin e kërkuar nga AK dhe që ka aftësinë e duhur për zbatimin e kontratës siç është parashikuar në DST, Ligji 32/2016 datë 24.03.2016 nën 13 pika 3,

Shënim për operatorët ekonomik:

Në zbatim të pikës 1, të Nenit 26, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike¹. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësura me origjinalin.

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.”

Gjithashtu risjellim në vëmendje se:

- Autoriteti/enti kontraktor përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, do t’i kërkojë ofertuesit të kualifikuar i pari nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet e bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e tjera të kërkuara sipas Shtojcës 8 të DST. Mosparaqitja e dokumentacionit përmbushës për keto pika do të jetë kusht skualifikimi.
- Autoriteti Kontraktor mund të bëjë verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetëdeklarimin e bërë gjatë fazës së ofertimit. Konstatimi i mospërputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përben kusht skualifikimi.
- Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Specifikime Teknike për Furnizim me Oxygen - Gaz për përdorim mjekësor i kompresuar x 100 %

Perberesit ne perqindje te oksigjenit te gazte mjekesore.

- | | | |
|--------------------|------------------|-----------------------------|
| - Oksigjen | O ₂ | 99,5 % |
| - Monoksid karboni | CO | 0,13 vpm (volum per milion) |
| - Bioksid karboni | CO ₂ | 0,11 vpm |
| - uje | H ₂ O | 0,06 vpm |
- Presioni i mbushjes se mbombulave te jete 125 bar
 - Sasia e oksigjenit ne bombula te jete 40 ose 50 litra per presion 125 bar
 - Amballazhimi te jete ne vellim 40 ose 50 litra
 - Bombula te kete shenjen dalluese “per perdorim spitalor” (O₂)

- Operatori duhet te garantoje mbajtjen e nje sasie rezerve brenda vendit, 150-200 bombola, minimalisht per nevojat 15 ditore.

Shenim:okigjeni I bombulave qe do te perdoret duhet te jete I regjistruar ne AKBPM per tregetim ne RSH.

Kushtet e furnizimit

OKSIGJEN GAZ (oxygen gaz per perdorim mjekesor, i kompresuar x 100 %)

Bombolat e oksigjenit duhet te shoqerohen me vertetimin e kryerjes se kontroleve periodike te **Inspektorati Shteteror Teknik dhe Industrial** (Drejtoria e Inspektimit te Pajisjeve nen Presion) ose/ **organet kompetente për regjistrimin, kontrollin e kushteve teknike dhe te sigurisë, per enët nën presion tankera/serbatore/cisterna**, sipas percaktimeve ligjore.

Transporti i bombolave te oksigjenit mjekësor, i kompresuar, duhet te bëhet me automjete të pajisur me :

1. Leje për Transport gazra mjekësore nën presion, të lëshuar nga Inspektoriati Shteteror Teknik dhe Industrial.
2. Leje për Transport gazra mjekësore nën presion të lëshuar nga MNZSH.
3. Certifikatë miratimi ADR të lëshuar nga DPSHTRR.

- **Argumentim:** Në bazë të nenit të 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion kërkesat e cilesise për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Sasia e mallit që kërkohet: 462,000 litra.

Afatet e lëvrim: për një periudhë 15 muaj nga nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër

Artikulli	Përshkrimi	Shuma	Destinacioni	Periudha e dorëzimit
	Furnizim me Oxygen - Gaz për përdorim mjeksori i kompresuar x 100%”	462 000 litra	QSRB	<i>brenda afatit të marrëveshjes kuader</i>

Afatet e lëvrim:

Draft Marrëveshja fituese do të lidhet pas përfundimit të kontratës aktuale që është në fuqi dhe sipas nevojave të Autoritetit kontraktor.

Do të lidhen disa minikontrata, brenda afatit të marrëveshjes kuader dhe fondit limit të parshikuar, sipas kërkesave dhe nevojave të Autoritetit kontraktor.

Afatet e ekzekutimit:

- Furnizimi bëhet sipas kërkesave dhe nevojave faktike të Institucioneve Spitalore për këtë artikull, bazuar në kontratën e lidhur.

-Transporti dhe shkarkimi i mallit është përgjegjësi e shitesit.

Institucionet Spitalore hartojnë grafikët mujor të lëvrimit të mallit, një kopje e të cilit i jepet furnizuesit në fund të çdo muaji për muajin pasardhës. Në cdo rast duhet lajmëruar furnizuesi dy ditë më parë.

NJESIA E PROKURIMIT

ARMELIN ÇILI

ELONA DUNDO

ADRIANO BEQOLLARI

MIRATOI

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

ARBEN KONOMI